

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.401/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.401/2021 të datës 11.05.2019 të parashtruar nga ankuesi nga Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.06.2021 mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.401/2021 e datës 11.05.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi masa disiplinore “Vërejtje” me numër protokollit 201 e datës 26.04.2021, e shqiptuar ndaj ankuesit nga Udhëheqësi i tij.

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën “Zyrtar Korrektues”, në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan, me datë 11.05.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2302/2021 të regjistruara me A.nr.401/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejtje” të shqiptuar me datë 22.04.2021 nga Udhëheqësi i tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 19.05.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë të ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritorë, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 11.05.2021 me numër protokollit 2302/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 26.04.2021 për shqiptimin e masës disiplinore; Shkresën e datës 29.03.2021; Kërkesën e ankuesit të datës 12.02.2021; Shfuqizimin e datës 08.02.2021; Vërtetimin e datës 04.02.2021; Raportin e ndërprerjes së përkohshme për punë i datës 03.01.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.05.2021; përgjigjen në kërkesë të datës 19.05.2021 me shkresat e bashkangjitura 1/35 faqe; Kontratën e punës së ankuesit të datës 30.06.2020; Përshkrimin e detyrave për pozitën "zyrtar korrektues" në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 11.01.2021; Raportin e informimit të datës 09.03.2021; Shkresën për themelimin e komisionit hetimor të datës 17.03.2021; Raporti i komisionit hetimor të datës 16.04.2021; vendimin e inspektoratit sanitar i datës 08.01.2021; Raportin e Ekzaminimit Mikrobiologjik të datës 04.02.2021; procesverbalin e datës 25.03.2021; Procesverbalin e datës 23.03.2021 për Procesverbali për dëshmitarin  
datës 23.03.2021; Procesverbalin për deklaratën e të datës 29.03.2021;  
Procesverbalin për deklaratën e të datës 26.03.2021; Procesverbalin për  
deklaratën e të datës 29.03.2021; Procesverbalin për deklaratën e të datës  
29.03.2021; Procesverbalin për deklaratën e të datës 29.03.2021; E-mailin e datës  
19.05.2021; Përgjigjen përmes e-maili të datës 14.06.2021 me prova shtese ¼ faqesh.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, konstatoj se ankesa e ankuesit është  
*e pa bazuar, sepse:*

Nga provat e lëndës gjegjësisht Kontratës së Punës të datës 30.06.2020, rezulton së ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pozitën e punës "Zyrtar Korrektues", në Qendrën Korrektuese në Lipjan.

Me datë 22.04.2021, Udhëheqësi i ankuesit bazuar në rekomandimet e Raportit të hetimit të datës 16.04.2021, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejte", për shkak të shkeljes së detyrave të punës, nga neni 43 paragrafi 4 nën paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik. Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se shqiptimi i masës disiplinore të kundërshtuar me ankesë, nuk është i drejtë dhe është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2021 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht nenin 4 paragrafi 1 me të cilin është përcaktuar se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë, rrjedhë se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht se të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil si dhe ligjeve të veçanta.*



Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, me te cilën është rregulluar procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil, ndërsa në kuptim të përcaktimit të përgjegjësive disiplinore, Kolegji ju referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ka përcaktuar se përgjegjësia disiplinore është *moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit.*

Nga vlerësimi i provave të lëndës respektivisht bazuar në Raportin e Komisionit Hetimor të datës 16.04.2021 si dhe deklaratimet e zyrtareve të pranishëm në datën e ngjarjes, Kolegji ka konstatuar se me datë 09.03.2021 ankuesi dhe mbikëqyrësi i ndërrimit A.J, në objektin e punës Pavioni "I " dhe në prani të burgosurve, kanë zhvilluar fjalosje, duke shkëmbyer dhe fjalë ofenduese ndaj njeri tjetrit, dhe si rrjedhojë Kolegji vlerëson se Komisioni Hetimor i emëruar sipas Vendimit me numër protokolli 127 të datës 17.03.2021 të Drejtorit të Qendrës Korrektuese për të Mitur në Lipjan, ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë përgjegjësive disiplinore të ankuesit dhe po ashtu në mënyrë të drejtë ka cilësuar veprimet e ankuesit si shkelje të lehta disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e mbi këtë konstatim rrjedhë se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Kolegji bazuar në rrethanat e konstatuara si me lartë si dhe duke marrë parasysh statusin e veçantë dhe specifikat e Shërbimit Korrektues të Kosovës, konstaton se udhëheqësi i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankuesi, ka vepruar në pajtim me kërkesat ligjore lidhur me parimet për individualizmin e masës disiplinore siç kërkohet me nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku shprehimisht thuhet se: *Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përprjekjet e mëparshme të nëpunësit për shumangien apo kufizimin e dëmit, si dhe neni 48 paragrafi 1 i po të njëjtit Ligj i cili përcakton se: Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.*


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me A.nr.401/2021

Flakron GASHI



Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demë



Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

